

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj synon harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, që lidhen me faturimin, me përcaktimet e ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili sjell një risi në procesin e faturimit e të monitorimit të transaksioneve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Në kuadër të objektivave për minimizimin e ekonomisë informale në vendin tonë, përmirësimit të mbledhjes të të ardhurave tatimore, por edhe në kuadër të nevojës që legjislacioni tatimor të jetë në të njëjtin drejtim me zhvillimet teknologjike, tashmë është duke u implementuar projekti “Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit (fiskalizimi)”, me përfitues Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ky projekt është materializuar edhe në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili njëkohësisht apo së shpejti do të shqyrtohet për miratim në Kuvend.

Në këtë kontekst, duke qenë se projektligji për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit sjell risi dhe ndryshime në sistemin e faturimit e të monitorimit të qarkullimit, përfshirë në një të ardhme të afërt edhe faturën elektronike (*e-invoice*), e cila deri më sot ishte parashikuar në ligjin që rregullon

tatimin mbi vlerën e shtuar në Shqipëri, por jo në fuqi, pasi i fillonte efektet në momentin e anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian, është e nevojshme të harmonizohen dhe të përshtaten dispozitat përkatëse të ligjit të TVSH-së lidhur me faturimin me parashikimet e këtij projektligji.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”, nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 16 nene, të cilat konsistojnë në ndryshime dhe shtesa të dispozitave përkatëse të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, që lidhen me faturimin, përfshirë edhe faturën elektronike.

Neni 1, duke ndryshuar nenin 51, të ligjit në fuqi, shton në rendin e furnizimeve të përjashtuara edhe automjetet vetëm me motor elektrik, të reja, me zero km e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, përveç atyre të përcaktuara në pikën 7, të nenit 49, të ligjit.

Neni 2 reflekton mospërdorimin e konceptit të kuponit tatimor si dokument tatimor, në parashikimet e nenit 58, të ligjit të TVSH-së.

Neni 3 harmonizon konceptin e faturës elektronike me atë të parashikuar në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 4 parashikon që faturimi të kryhet sipas rregullave të përcaktuara në seksionin e faturimit në ligjin e TVSH-së dhe të ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, për të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, vendi i të cilave është në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5 parashikon dokumentimin e transaksioneve të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas shkronjave nga “a” deri në “e”, të nenit 53.

Neni 6 parashikon detyrimin e personit të tatueshëm për lëshimin e faturës, për çdo furnizim tjetër të mallrave ose shërbimeve, pavarësisht vlerës së furnizimit, në përputhje me ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, pra rasti biznes-konsumator (B2C).

Neni 7 parashikon ndryshimin e datës nga 14 në 10, për lëshimin e faturës nga ana e marrësit të furnizimit (*reverse-charge*).

Neni 8 parashikon disa ndryshime dhe rregullime në nenin 101 të ligjit aktual, me qëllim harmonizimin me parashikimet përkatëse të ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 9 parashikon shfuqizimin e nenit 102 të ligjit.

Neni 10 parashikon mundësinë që faturat tatimore dhe dokumentet e tjera të lëshuara, të vihen në dispozicion në letër ose në formë elektronike, në përputhje kjo me ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 11 parashikon se vërtetësia e origjinës, integriteti i përmbajtjes dhe lexueshmëria e një fature, qoftë kjo në letër apo në formë elektronike, duhet të garantohen në përputhje me përcaktimet e ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, duke filluar nga momenti i lëshimit të saj deri në përfundimin e periudhës së ruajtjes së faturës.

Neni 12 parashikon krijimin automatik të deklaratës së TVSH-së nga autoriteti tatimor, bazuar në informacionin e dhënë në librin e blerjeve dhe në librin e shitjeve, detyrimin e personit të tatueshëm për të kontrolluar të dhënat në deklaratë dhe për të bërë ndryshime në përputhje me librin e blerjeve dhe të shitjeve, nëse lind nevoja, si dhe në fund konfirmimin dhe dorëzimin e saj brenda afatit të përcaktuar.

Nenet 13 dhe 14 reflektojnë rregullimet për harmonizimin e dispozitave të neneve 109 dhe 110 të ligjit aktual me dispozitat përkatëse të ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 15 parashikon shfuqizimin e pikës 2, të nenin 157.

Neni 16 përcakton rregullime për periudhën kalimtare, nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji deri në përdorimin e detyrueshëm të faturave elektronike, sipas ligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Neni 17 parashikon hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe fillimin e zbatimit të tij në përputhje me afatet e përcaktuara në ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin dhe administrimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji nuk parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE